

Raporti i IKD-së: 25 kandidatë për deputetë të përfshirë në raste penale, prin LV-ja | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



PREMTIME DHE AKUZA NË GARËN PËR PUSHTET

FAQE 4-5



Me premtime për rritje pagash e pensionesh, zhvillim ekonomik, investime në infrastrukturë dhe përmirësim të shërbimeve publike, partitë politike kanë hapur zyrtarisht fushatën për zgjedhjet e

7 qershorit. Derisa Vetëvendosje ka mbrojtur rezultatet e qeverisjes së saj në pesë vitet e fundit, partitë opozitare e kanë akuzuar pushtetin për krizën ekonomike, stagnim dhe

përkeqësim të raporteve me aleatët ndërkombëtarë. Me premtime për rritje të pagave dhe pensione për 50 për qind, PDK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve t'i thonë stop krizës dhe ta votojnë numrin 125

AKTUALE



FETOSHI: SERBIA SYNON TA MINOJË DEMOKRACINË NË KOSOVË DHE TA KONTROLLOJË VOTËN E SERBËVE PËRMES LISTËS SERBE F. 6

ÇFARË MODELI TË MBROJTJES GJITHËPËRFSHIRËSE KA FINLANDA TË CILIN PO E MERR SHEMBULL KURTI? F. 7

SORENSEN I TAKOHET ME PIERCEN, NË FOKUS DIALOGU KOSOVË - SERBI F. 6

EKONOMI



GUVERNATORI ISMAILI: BQK-ja TRANSFERON RRETH 38 MILIONË EURO PËR BUXHETIN E SHTETIT NË TRI VITET E FUNDIT F. 8

ZKA-ja PJESË E PROGRAMIT STUDIMOR NË HOLANDË PËR MENAXHIMIN DHE AUDITIMIN E FONDEVE TË BE-së F. 8

SPORT



ETNIK BRRUTI ZYRTARIZOHET TE HAJDUKU I SPLITIT F. 11



KUSH E KONTROLLON PËRDORIMIN E PARASË PUBLIKE NË KOHË ZGJEDHJESH? F. 5

FSK-ja REALIZON USHTRIMIN FUSHOR VALIDUES 'UJKU I PAMPOSHTUR 01' F. 8



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rusia kryen sulm me dron mbi një ndërtesë banimi në Rumani, reagon NATO

BUKURESHI, 29 MAJ - Një dron është rrëzuar në një ndërtesë banimi në qytetin Galați, Rumani, vend anëtar i NATO-s. Përplasja ka shkaktuar zjarr. Dy persona janë plagosur lehtë, sipas RBC-Ukrainë, duke cituar "Faytuks Network" dhe faqen zyrtare në "Facebook" të Shërbimit Rumun të Reagimit ndaj Emergjencave. Supozohet se droni ishte rus, pasi Federata

Ruse po kryente një sulm masiv me dron në rajonin e Odessas në atë kohë, dhe Galați ndodhet afër. "Sipas raporteve fillestare, një dron rus u rrëzua në një ndërtesë apartamentesh në qytetin e Galațit, Rumani. Përplasja ndodhi menjëherë pasi autoritetet lëshuan një paralajmërim për 'mundësinë e rënies së objekteve nga hapësira ajrore përreth'", ka

raportuar "Faytuks Network". Sipas Shërbimit të Reagimit ndaj Emergjencave (ISU), droni ka rënë në një ndërtesë banimi dhe impakti ka shkaktuar një shpërthim që ka shkaktuar zjarr në një apartament në katin e dhjetë. Ministria rumune e Mbrojtjes ka konfirmuar se të premtet një dron rus ka goditur një ndërtesë banimi në Rumani,



një vend anëtar i NATO-s, shkruan "ANSA".

Rumania e ka quajtur ndërhyrjen, së bashku me shkëlqen e hapësirës së saj ajrore, "një përshkallëzim serioz dhe të papërgjegjshëm". Ndërsa NATO ka reaguar ndaj këtij veprimi të Rusesë. Në deklaratën e saj, aleanca ushtarake perëndimore ka dënuar ashpër veprimet e Rusesë, duke i cilësuar të papërgjegjshme.

I DËRGUARI I KIEVIT THOTË SE RAKETAT "PATRIOTË" JANË JETIKE, ZELENSKY I LUTET TRUMPIT

KIEV, 29 MAJ - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, u ka bërë thirrje të drejtpërdrejtë presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump dhe Kongresit amerikan, duke paralajmëruar se vendi i tij ka nevojë jetike për sisteme shtesë raketore "Patriotë", sepse Rusia është duke i rritur sulmet me raketa balistike ndaj qyteteve ukrainase. Në një letër pesëfaqëshe, të dorëzuar në Shtëpinë e Bardhë dhe në Kongres, Zelensky tha se aftësia e Ukrainës për t'i mbrojtur civilët tani varet kryesisht nga sistemet "Patriotë" të prodhuara në ShBA, duke i përshkruar raketat balistike si një nga përparësitë kryesore që i kanë mbetur Moskës në fushën e betejës.

Ambasadorja e Ukrainës në Shtetet e Bashkuara, Olha Stefanishyna, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë (REL)", në një intervistë më 27 maj, se mesazhi i Kievit në letër ishte se ndryshimet në retorikën diplomatike nuk e kanë ndryshuar gjendjen në terren. "Mund të ketë retorikë të ndryshme diplomatike, dinamika të ndryshme diplomatike, prioritetet të ndryshme, por realiteti nuk po ndryshon. Realiteti në terren nuk po ndryshon. Njerëzit po vdesin", ka theksuar ajo.

Zelensky ka shkruar në letër, një kopje e së cilës është siguruar nga REL-i, se ndërsa "fati i jetës së shumë njerëzve" po vendoset në luftë, sistemet "Patriotë" mbeten "mbrojtja më efektive kundër çdo lloj rakete balistike ruse".

Kjo thirrje vjen në një kohë kur

administrata Trump po vazhdon t'i shmangë paketat e mëdha të ndihmës direkte ushtarake për Kievin, duke u mbështetur në listën e "Kërkesave Prioritet për Ukrainën" (PURL), sipas të cilit, aleatët e NATO-s blejnë sisteme armësh amerikane për Ukrainën. Por, Zelensky ka paralajmëruar se dërgesat në kuadër të këtij programi nuk po ecin me ritmin e nevojave në fushën e betejës. "Ritmi i tanishëm i dërgesave përmes programit 'PURL' nuk po arrin më të përputhet me realitetin e kërcënimit me të cilin përballlemi", ka shkruar ai.

Presidenti ukrainas, gjithashtu, ka theksuar rritjen e kërkesës globale për interceptorët "Patriotë" mes presioneve më të gjera ndërkombëtare të sigurisë dhe kërkesave konkurruese për rezervat amerikane. "Për ne, për një komb që lufton për mbijetesë, vështirë se ka diçka më të dhimbshme sesa të shohësh bateri 'Patriotë' pa raketa të ngarkuara", ka shkruar Zelensky.

Në një postim në rrjetet sociale më 27 maj, Zelensky ka thënë se, megjithëse mund të jetë shumë e pazakontë që një lider i huaj t'i drejtohet njëkohësisht presidentit amerikan dhe Kongresit, kjo gjendje kërkon "veprim të shpejtë dhe efektiv". "Është e rëndësishme që Amerika ta dëgjojë Ukrainën", ka thënë ai, duke vënë në dukje se lufta e Rusesë kundër Ukrainës - tashmë në vitin e saj të pestë - mbetet luftë për ekzistencë. "Sa më shpejt të jemi në gjendje të kemi mbrojtje më të madhe kundër kërcënimeve



balistike, aq më shpejt do të mund ta bëjmë diplomacinë të funksionojë. Për sa kohë Rusia vazhdon të mbështetet te raketat, interesi i saj për diplomaci nuk është i mirëfilltë", ka thënë ai.

Kjo thirrje ka shkaktuar reagime të shpejta në Kongres. Ligjvënësi i lartë republikan, Joe Wilson, i ka thënë "REL"-it se Ukraina mbetet partnere kyçe në përballjen me kundërshtarët e përbashkët. "Ukrainasit po mbrojnë me guxim atdheun e tyre ndërsa po përfshijnë dhe po qëndrojnë përkrah Amerikës kundër regjimit terrorist në Teheran. Krimineli i luftës, Putin, po vret besimtarë nëpër kisha dhe fëmijë që luajnë, ndërsa furnizon hapur terroristët në Teheran për të vrarë amerikanë. Ai po humb dhe është i dëshpëruar. Mbrojtja ajrore shpëton jetë dhe Ukraina është partnere e provuar kundër terrorizmit", ka thënë ai.

"REL"-i ka kontaktuar Shtëpinë e Bardhë për koment, por nuk ka marrë përgjigje të menjëhershme. Disa zyra të

Kongresit kanë thënë se ligjvënësit e tyre ende nuk e kishin shqyrtuar letrën. Stefanishyna ka thënë se Rusia, "në dëshpërimin e saj" dhe nën "presion të madh nga të gjitha anët", po përshkallëzon sulmet, përfshirë goditjet me raketa, luftën kibernetike, fushatat e dezinformimit dhe përpjekjet për frikësim ndaj Ukrainës dhe partnerëve të saj.

Ambasadorja ka thënë se aftësia e Ukrainës për t'i luftuar raketat balistike mbetet pothuajse tërësisht e varur nga Shtetet e Bashkuara. "E vetmja gjë që është vetëm në dispozicion të qeverisë amerikane është aftësia për t'i interceptuar raketat balistike. Dhe ky është një kapacitet mbrojtës që na nevojitet dhe i vetmi për të cilin jemi vërtet të dëshpëruar të arrijmë marrëveshje me Shtetet e Bashkuara", ka thënë ajo, duke shtuar se Ukraina është e gatshme të financojë sisteme dhe interceptorë shtesë.

Një argument qendror në letrën e Zelenskyt është se mbrojtja më e fortë ajrore mund të ndihmojë në ndryshimin e

llogaritjeve të Moskës dhe të krijojë hapësirë për diplomaci. "Raketat balistike janë përparësia e fundit madhore për Putinin", ka shkruar ai, duke paralajmëruar se Rusia do të vazhdojë t'i përdorë sulmet me raketa "për ta shmangur diplomacinë" nëse Ukraina nuk arrin ta kundërshtojë kërcënimin.

Stefanishyna ka thënë se Moska po përpiqet t'i shfrytëzojë përçarjet mes aleatëve perëndimorë. Ajo ka paralajmëruar se sulmet ruse mund të shtohen edhe më tej. Ndërsa William B. Taylor Jr., i cili ka shërbyer diplomat kryesor i Uashingtonit në Kiev gjatë presidencës së George W. Bush, edhe gjatë administratës Trump, ka thënë se nevoja e Ukrainës për sistemet "Patriotë" është bërë gjithnjë e më urgjente. Taylor ka thënë se mungesa globale për interceptorë "Patriotë" është duke e ndërlikuar pozitën e Ukrainës. Ai ka argumentuar se trysnia ndërkombëtare ndaj Rusesë duhet të rritet për shkak të sulmeve të saj ndaj civilëve. Taylor ka thënë se mbështetja për zhvillimin e mbrojtjes ajrore të Ukrainës duhet të mbetet prioritet për qeveritë perëndimore. Letra shënon një nga thirrjet më të drejtpërdrejta të Kievit deri tani ndaj udhëheqjes amerikane që nga fillimi i luftës, duke nënvizuar shqetësimin në rritje në Ukrainë se vonesat në dërgesat e mbrojtjes ajrore mund t'i lënë qytetet gjithnjë e më të ekspozuara ndaj sulmeve me raketa balistike ruse.

Kryediploti italian: Zgjerimi i BE-së drejt Ballkanit Perëndimor, investim strategjik



LIMASOL, 29 MAJ - "Mbështesim fillimin e një procesi që do ta sjellë Ukrainën në Bashkimin Evropian (BE), por nuk duhet të harrojmë se ka edhe vende të tjera kandidate", ka deklaruar ministri i Jashtëm,

Antonio Tajani, në Limasol. "Për ne përparësia është Ballkani Perëndimor", ka thënë Tajani duke kuptuar se Ukraina dhe Moldavia duhet të nisin një proces, ta luftojnë korrupsionin dhe t'i respektojnë rregullat për

anëtarësim në Bashkimin Evropian. "Ne jemi të gatshëm të bëjmë pjesën tonë për t'i ndihmuar ata. Ribashkimi i Ballkanit në historinë evropiane është një përparësi themelore për mua personalisht dhe për

qeverinë italiane. Është investimi më i rëndësishëm strategjik për BE-në. Duhet të përshpejtojmë. Mund të ndërtojmë një hapësirë të madhe stabiliteti për ato vende dhe bizneset tona", ka thënë Tajani.

KUSH E KONTROLLON PËRDORIMIN E PARASË PUBLIKE NË KOHË ZGJEDHJESH?

Në prag të zgjedhjeve të 7 qershorit, Qeveria në detyrë e Kosovës shpërndau miliona euro në mbështetje sociale dhe subvencione, duke nxitur akuza nga opozita dhe shoqëria civile për përdorim elektoral të parasë publike. Kush mund t'ia ndalojë pushtetit veprimet e tilla në periudha zgjedhore?

PRISHTINË, 29 MAJ - Kur një qeveri shpërndan para publike në prag të zgjedhjeve, kufiri mes politikës sociale dhe ndikimit elektoral bëhet i paqartë. Në Kosovë ky kufi u sprovua sërish pas vendimeve të fundit të qeverisë në detyrë të Albin Kurtit për një sërë masash të mbështetjes sociale në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të 7 qershorit. Në ditët para hapjes së fushatës zgjedhore më 28 maj, ajo ndau nga 100 euro si përkrahje e njëhershme për pensionistët, studentët, fëmijët dhe punëtorët, e rriti në 500 euro mbështetjen për lehonat dhe ndau dy milionë euro subvencionim për kompanitë ajrore për t'ua lehtësuar fluturimin mërgimtarëve gjatë verës. Mbështetje e tillë ad hoc ishte dhënë edhe në prag të zgjedhjeve të kaluara më 2025. Vendimet nxitën kritika nga shoqëria civile dhe opozita, e cila i cilësoi veprimet e qeverisë në detyrë si përpjekje për "blerje votash".

Ligjet e tanishme në Kosovë nuk ia ndalojnë qartazi një qeverie ndarjen e ndihmave sociale apo subvencioneve në kohë parafushate apo në prag të zgjedhjeve.

Çfarë ndryshimesh mund të bëhen?

Naim Jakaj, hulumtues në Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), thotë për Radion Evropa e Lirë se do të duhej të përcaktohej qartë me ligj se, pas shpalljes së datës së zgjedhjeve, qeveria në detyrë nuk duhet dhe nuk mund të marrë vendime për ndarjen e pakove të reja financiare për kategori të caktuara shoqërore. Qeveria në detyrë, sipas parimit të kufizimit të veprimeve të saj, duhet të ushtrojë vetëm funksione të domosdoshme dhe ta vazhdojë zbatimin e politikave të nisura apo të planifikuara paraprakisht, vlerëson ai.

Jakaj thotë se "ajo nuk duhet të



ketë hapësirë që, përmes vendimeve të veçanta, të transferojë mjete publike për kategori të caktuara, nëse këto mjete nuk janë të planifikuara qartë dhe nëse vendimi mund të prodhojë efekt elektoral". Për këtë arsye, nënvizon ai, është e nevojshme të krijohet një periudhë "fiskale neutrale" para zgjedhjeve, gjatë së cilës një qeveri nuk mund të shpallë masa të reja financiare apo subvencione, pasi çdo ndërhyrje e tillë krijon pabarazi në garën zgjedhore dhe rrezikon që buxheti publik të përdoret për ndikim zgjedhor.

Po ashtu, këshillon ai, nevojitet një kod i sjelljes për qeverinë gjatë periudhës zgjedhore, veçanërisht për përdorimin e resurseve shtetërore, si automjetet zyrtare, derivatet e të tjera, në mënyrë që partia që qeveris të mos ketë përparësi ndaj partive të tjera.

Ligji i tanishëm për Zgjedhjet nuk specifikon nëse vendime si këto të qeverisë në detyrë, në prag të fillimit të fushatës

zgjedhore, janë të kundërligjshme.

Meqë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) nuk ka rol të drejtpërdrejtë në kontrollin e shpenzimeve publike të qeverisë, pasi mandati i saj lidhet kryesisht me administrimin e procesit zgjedhor, Jakaj thotë se Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duhet të ketë rol më aktiv në vlerësimin e konfliktit të interesit dhe të keqpërdorimit të resurseve shtetërore gjatë fushatës. Gjithashtu, sipas tij, Zyra Kombëtare e Auditimit duhet të bëjë inspektim të veçantë për shpenzimet publike në periudhën parazgjedhore dhe zgjedhore, sidomos për subvencionet dhe vendimet ad hoc të qeverisë.

Në prill IKD-ja e dorëzoi në Kuvend një nismë legislative për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Penal, ku njëra nga fushat kryesore lidhet pikërisht me kriminalizimin e keqpërdorimit të parasë publike

për përfitim elektoral gjatë periudhave zgjedhore dhe parazgjedhore.

Kur ndihmat lidhen me zgjedhjet

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Komisioni i Venecias i Këshillit të Evropës thanë më 2016, përmes një udhëzuesi, se ligjet shtetërore duhet të garantojnë ndalesa të qarta dhe të zbatueshme kundër përdorimit të buxhetit dhe infrastrukturës shtetërore për përfitime zgjedhore. Sipas udhëzuesit, keqpërdorimi i mjeteve publike është fenomen i konsoliduar dhe i përhapur në shumë vende evropiane, dhe keqpërdorimet ndodhin gjatë gjithë procesit zgjedhor, dhe jo vetëm gjatë periudhës zyrtare të fushatës zgjedhore.

Për shembull, në një raport më 2022, misioni vëzhgues i OSBE-së gjeti se qeveria në detyrë në Serbi paraqiti një sërë skemash

financiare për të joshur demografi specifike votuesish pak para zgjedhjeve parlamentare e presidenciale të atij viti. Ajo ndau pagesa të njëhershme prej 100 eurosh për të rinjtë, dhe pagesë prej 2 500 eurosh për të sapolindurit. OSBE-ja tha se, derisa shteti pretendoi se këto ishin masa për mirëqenie publike, koha dhe shpërndarja e tyre në mënyrë të paplanifikuar dhe të jashtëzakonshme ishin në kundërshtim me rekomandimet e Komisionit të Venecias.

Si i ka arsyetuar Kurti vendimet?

Kryeministri në detyrë i Kosovës i ka hedhur poshtë kritikën se vendimet për mbështetje financiare nga qeveria në kohë zgjedhjesh janë "blerje votash". Duke reaguar në veçanti për subvencionimin prej dy milionë eurosh për linjat ajrore, Kurti tha më 27 maj se këtë e bëri për ta shmangur anulimin e mundshëm të fluturimeve në muajt gusht dhe korrik për shkak të rritjes së kostos së karburantit, por pa ofruar dëshmi.

Mbështetja për mërgatën përfshihet në Pakon e Ringjalljes Ekonomike, të miratuar fillimisht më 2021, por ajo nuk specifikon subvencionim për kompanitë e fluturimeve.

Ministria e Financave nuk iu përgjigj pyetjes së Radios Evropa e Lirë nëse subvencionimi i linjave ajrore ishte parashikuar më herët, apo nëse do të jetë përkrahje afatgjatë.

Qeveria në detyrë i ekzekutoi shtesat për lehonat me vlerën e re, të rritur, prej 500 eurosh më 24 maj, më shumë se një muaj para se paga minimale prej 500 eurosh të hynte në fuqi.

Kurti nuk tregoi arsyen pse e shmangu pritjen deri në korrik.

MASH dhe komuna e Mitrovicës së Jugut nënshkruajnë memorandum bashkëpunimi

PRISHTINË, 29 MAJ - Ministri në detyrë i Arsimit dhe Shkencës, Hajrulla Çeku, dhe kryetari i Mitrovicës së Jugut, Faton Peci, nënshkruan memorandum mirëkuptimi për zhvillimin e dokumentacionit projektues për ndërtimin e objekteve të Gjimnazit "Frang Bardhi" dhe Shkollës së Muzikës "Tefta Tashko" në Mitrovicë

të Jugut.

Qëllimi i memorandumit është krijimi i kornizës së bashkëpunimit institucional ndërmjet Ministrisë dhe komunës së Mitrovicës së Jugut për përgatitjen e projektit ideor dhe projektit të hollësishëm për këto dy institucione arsimore si dhe bashkërendimin e veprimeve teknike, administrative dhe

institucionale të nevojshme për realizimin e tyre.

Ndërtimi i objektit të ri të Gjimnazit "Frang Bardhi" dhe objektit të Shkollës së Muzikës "Tefta Tashko" do të krijojë kushte më të mira për mësim dhe do të kontribuojë në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe ngritjen e cilësisë së arsimit në këtë komunë.





PREMTIME DHE AKUZA NË GARËN PËR PUSHTET

Me premtime për rritje pagash e pensionesh, zhvillim ekonomik, investime në infrastrukturë dhe përmirësim të shërbimeve publike, partitë politike kanë hapur zyrtarisht fushatën për zgjedhjet e 7 qershorit. Derisa Vetëvendosje ka mbrojtur rezultatet e qeverisjes së saj në pesë vitet e fundit, partitë opozitare e kanë akuzuar pushtetin për krizën ekonomike, stagnim dhe përkeqësim të raporteve me aleatët ndërkombëtarë. Me premtime për rritje të pagave dhe pensione për 50 për qind, PDK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve t'i thonë stop krizës dhe ta votojnë numrin 125

EPOKA ERE

Mal QORRAJ

Prishtinë, 29 maj - Partitë politike në ditën e parë të fushatës kanë dhënë zotimet e tyre për qeverisjen katërvjeçare në vend. Derisa partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, është krenuar për qeverisjen në pesë vitet e fundit, partitë opozitare kanë drejtuar akuza për keqqeverisje. Vetëvendosja në fushatën e hapur në Ferizaj ka kërkuar që të mbështetet kjo lëvizje për zgjedhjet e 7 qershorit.

Fjalën hapëse të këtij tubimi e ka mbajtur kryetari i Qendrës së LV-së në Ferizaj dhe kandidati për deputet, Enver Haliti, i cili ka thënë se "fitorja e Lëvizjes Vetëvendosje! vjen sepse i qëndruam gjithmonë besnik popullit, shtetit dhe rrugës së drejtë".

Më pas fjalën e ka marrë kryeministri në detyrë dhe lideri i LV-së, Albin Kurti, i cili ka risjellë në vëmendje cilësitë e Ferizajt si qytet me traditë e me kulturë, të njerëzve patriotë e punëtorë, qytet mes Prishtinës dhe Shkupit, qytet i hekurudhës e stacionit hekurudhor. "E sot, katër stacione hekurudhore në veri të Ibrit janë nën kontroll të Republikës së Kosovës. Pra, stacionet hekurudhore nuk i doni vetëm ju, por i duam të gjithë ne", u ka thënë ai

qytetarëve.

Më tutje, Kurti ka folur rreth rritjes ekonomike prej 4-përqindësh teksa ka theksuar edhe rritjen që ka ndodhur në sektorin privat si bartës kryesor i punësimit, duke shtuar se këtë rritje ekonomike shteti e shpërndan për të gjithë. Krahas kësaj, ai ka thënë se ata që në të kaluarën kanë zhvatur pasuri natyrore dhe buxhet shtetëror do ta kthejnë atë, sepse do të funksionalizohet byroja për konfiskimin dhe sekustrimin e pasurisë së pajustificueshme. "Ligji për Çmimet Tavan do të ndihmojë në parandalimin e abuzimit me marzhat tregtare dhe manipulimet në treg, në mbrojtje të konsumatorëve dhe tregtarëve të ndershëm", ka

thënë Kurti, duke shtuar se kjo mund të ishte realizuar qysh prej dhjetorit 2022 nëse opozita nuk do ta bllokonte atë në Gjykatë Kushtetuese.

Në fjalën e tij, kryeministri Kurti ka vijuar duke thënë se prej vitit të ri do të fillojë plani për kontrollin e mbikëqyrjes shëndetësore për çdo qytetar, ku çdo vit të gjithë do ta kenë një kontroll të plotë mjekësor të njohur si "Check-Up", i cili parandalon dhe ndihmon kundrejt çdo rreziku që vjen nga problemet shëndetësore. Ai ka përmendur investimet që janë bërë, që po bëhen e që do të bëhen në Ferizaj, të cilat janë: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, spitali i qytetit, rruga magjistrale që synohet të



përfundohet këtë tetor, stadiumi i qytetit, restaurimi në gjimnazin "Ismail Qemali", palestra në Greme, restaurimi në Kishën Katolike, restaurimi në xhaminë e qytetit, restaurimi në teatrin e qytetit, Qendra Multifunkionale, përkrahja për bujqësinë, çerdhja, shkollat, rrugë dhe shumë investime të tjera.

Më pas, Kurti ka folur për themelimin e Xhandarmërisë së Republikës së Kosovës. "Ajo do të ketë për mision mbrojtjen e sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial përmes sigurimit të kufijve, luftimit të terrorizmit, menaxhimit të situatave me rrezikshmëri të lartë, mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe objekteve strategjike të vendit. Së paku 18 vende të BE-së kanë xhandarmëri. Do ta forcojmë ushtrinë tonë, sepse duam të integrohemi në NATO. Dhe në frymën e idealeve të dëshmorëve të kombit, të luftëtarëve të UÇK-së, do ta krijojmë një njësi të përbashkët: Forca e Sigurisë së Kosovës me Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", ka thënë Kurti.

Para qytetarëve të Ferizajt, Kurti

ka paraqitur kandidatët për deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje! të cilët janë nga ky qytet. "Me 15 minuta kohë deri në vendotim i fitoni katër vjet me mirëqenie dhe dinjitet, me integritet e sovranitet, me qëllim e me përparim, sepse ne angazhohemi për një Shtet për Krejt, andaj më 7 qershor 'Krejt për Shtet', numri 116, Lëvizja Vetëvendosje! Qitja pikën!", ka thënë Kurti.

Hamza: Qeveria jonë do të jetë e punës, zhvillimit dhe e dinjitetit për qytetarët

Edhe Partia Demokratike e Kosovës ka hapur zyrtarisht fushatën për zgjedhjet e 7 qershorit në Ferizaj, ku kryetari dhe kandidati për kryeministër i kësaj partie, Bedri Hamza, ka paraqitur programin e tij qeverisës. Ai në një tubim madhështor në Ferizaj u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i thonë stop krizës dhe ta votojnë numrin 125 - Partinë Demokratike të Kosovës. "Më 7 qershor ju do të vendosni: A do të vazhdojmë me krizë? Apo do ta

RAPORTI I IKD-SË: 25 KANDIDATË PËR DEPUTETË TË PËRFSHIRË NË RASTE PENALE, PRIN VV-ja

Pri9shtinë, 29 maj - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka publikuar një raport lidhur me kandidatët e certifikuar për zgjedhjet e parakohshme parlamentare, duke bërë të ditur se 25 prej tyre rezultojnë të përfshirë në raste penale.

Sipas hulumtuesit të lartë të IKD-së, Gzim Shala, në zgjedhjet e 7 qershorit do të marrin pjesë 21 subjekte politike me gjithsej 902 kandidatë të certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. “Në zgjedhjet e parakohshme të 7 shkurtit do të marrin pjesë 21 subjekte politike të cilat janë certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve e në të cilat bëjnë pjesë gjithsej 902 kandidatë. Nga këta 902 kandidatë, bazuar

në të dhënat e Institutit të Kosovës për Drejtësi, rezultojnë se 25 prej tyre janë të përfshirë në raste penale. Shprehur në përqindje i bie se 2.77% e totalit të listave të kandidatëve janë persona të cilët kanë ose dënime të formës së prerë ose aktakuza aktive”, tha ai.

Ai tha se nga ky numër, 25 kandidatë kanë ose aktakuza aktive ose dënime të formës së prerë nga e kaluar. “15 prej tyre janë me aktakuza aktive, ndërkaq 13 të tjerë janë persona të cilët në të kaluarën kanë pasur dënime penale. Ndërkaq janë evidentuar edhe tri raste, tri kandidatë të cilët përpos aktakuzës aktive në të njëjtën kohë kanë edhe dënime penale”, tha ai.

Sipas raportit, Lëvizja

Vetëvendosje ka numrin më të madh të kandidatëve me probleme me ligjin, gjithsej 13 kandidatë. “Sa i përket subjekteve politike, numrin më të madh të kandidatëve të cilët kanë probleme me ligjin e mban Lëvizja Vetëvendosje me gjithsej 13 kandidatë, që në raport me listën e përgjithshme prej 902 kandidatëve pjesëmarrja e këtij subjekti është 1.44%. AAK dhe Lista Serbe kanë nga 3 kandidatë të cilët kanë probleme me ligjin që përbën 0.33% të listës së përgjithshme. PDK-ja me 2 kandidatë që përbën 0.22% të listës së përgjithshme, ndërkaq katër subjekte të tjera kanë të përfshirë nga 1 kandidat i cili ka probleme me ligjin”, tha ai.

IKD-ja bëri të ditur se veprat penale që dominojnë janë ato që



lidhen me korrupsionin zyrtar, ndërsa përdorimi i armës është vepra penale më e shpeshtë në mesin e kandidatëve të përfshirë në raste gjyqësore. “Sa i përket kapitujve të veprave penale për të cilat ose janë dënuar ose

akuzohen kandidatët në fjalë, sipas kapitujve dominojnë veprat penale të korrupsionit zyrtar, ndërkaq sipas veprave penale, vepra më e shpeshtë është vepra e përdorimit të armës”, tha ai.

ndryshojmë Kosovën? Unë besoj që Kosova është gati. Gati për stabilitet. Gati për kompetencë. Gati për zhvillim. Gati për rezultate. Dhe unë besoj që bashkë do ta ndalim krizën. Bashkë do ta ndryshojmë Kosovën. Stop krizës! Ndrysho Kosovën! Voto PDK 125”, ka thënë ai.

Hamza ka paraqitur pesë zotimet kryesore të programit të PDK-së: çmime e tatime më të ulëta, paga e pensione më të larta dhe mbështetje për bizneset; investime në energji, infrastrukturë dhe teknologji të reja; shëndetësi cilësor, me shërbime më të shpejta dhe të qasshme për çdo qytetar; arsim konkurrues, aftësi për të ardhmen dhe mundësi për të rinjtë; si dhe drejtësi e pavarur, e paanshme dhe efektive. “Qeveria jonë do të jetë qeveri e punës. Qeveri e zhvillimit. Qeveri e dinjitetit për qytetarët. Ne do t'i ulim çmimet. Do ta heqim TVSh-në për produktet esenciale. Qytetarët duhet të kenë më shumë para në xhepin e tyre, jo më shumë barrë mbi shpinë. Ne do t'i rrisim pagat dhe pensionet. 50 për qind rritje për sektorin publik. 50 për qind rritje për pensionet dhe ndihmat sociale. Asnjë ndihmë sociale nën 250 euro. Sepse askush në Kosovë nuk duhet të jetë pa dinjitet”, ka premtuar kryetari i PDK-së.

Hamza ka shprehur shqetësimin se Kosova sot është në krizë ekonomike, sociale e politike, sepse për gjashtë vjet është keqeverisur nga një kryeministër si Albin Kurti, i cili ka qasje konfliktuale me të gjithë aktorët. “Derisa ju luftoni me faturat, me kreditë, me çmimet, me pasigurinë për të ardhmen e fëmijëve tuaj, Kryeministri aktual lufton me të gjithë. Lufton opozitën. Lufton bizneset. Lufton mediat. Lufton komnatat. Lufton edhe aleatët tanë strategjikë. E derisa ai lufton me të gjithë - Kosova stagnon. Miqtë e mi, Kosova nuk ka më kohë për drama politike. Kosova ka nevojë për punë. Ka nevojë për



stabilitet. Ka nevojë për leadership serioz. Ka nevojë për rezultate. Këto zgjedhje nuk janë për një politikan. Këto zgjedhje janë për ju”, ka thënë ai.

Në vazhdim të fjalës së tij, Hamza ka thënë se nga sot fillon puna për rikthimin e Kosovës në rrugën e zhvillimit, partneritetit, dinjitetit dhe ecjes përpara. “Kosova nuk është ndërtuar nga njerëz që ikën nga përgjegjësia. Kosova është ndërtuar nga burra dhe gra që sakrifkuan gjithçka për këtë vend. Partia Demokratike e Kosovës mban mbi supë një pjesë të madhe të historisë së shtetndërtimit të Kosovës. Nga lufta për liri, tek shpallja e pavarësisë, tek ndërtimi i institucioneve të shtetit tonë. Dhe sot, liderët tanë Hashim Thaçi e Kadri Veseli, dhe bashkëluftëtarët e tyre Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi, tanë ndodhen larg familjeve të tyre, në Hagë. Ne besojmë në drejtësi. Ne besojmë në të vërtetën. Dhe ne besojmë se historia nuk mund të rishkruhet. Ata nuk janë vetëm individë. Ata janë pjesë e historisë së Kosovës. Dhe unë besoj fort se ata do të kthehen faqebardhë”, ka thënë Hamza.

Në tubimin e PDK-së në Ferizaj ka marrë pjesë edhe lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, i cili është duke i dhënë mbështetje partisë më të madhe opozitare për zgjedhjet e 7 qershorit.

LDK-ja shpaloj 113 zotimet për zgjedhjet e 7 qershorit

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe kandidatja për presidente, Vjosa Osmani, në tubimin hapës të fushatës në Prishtinë, kanë thënë se ky rrugëtim nuk është vetëm politik, por është mision historik. Abdixhiku në fjalën e tij ka përmendur 113 zotimet e programit qeverisës. Ai ka thënë se LDK-ja ka një plan pune për një Kosovë që punon, zhvillohet dhe e bën jetën e qytetarit më të lehtë. “Ky është plani ynë për shtet që punon, për familje që mbështeten, për të rinj që ndërtojnë jetë këtu, për ekonomiq që zhvillohet dhe për Kosovë me dinjitet në botë. Bashkohu!”.



Ndërsa ka renditur 10 premtimet kryesore të planprogramit: 1. Paga më të larta menjëherë. Koefficienti 150 dhe dyfishimi i pensioneve. 2. Punë për çdo të ri të diplomuar. Punësim i garantuar dhe trajnim për 40 mijë të rinj. 3. Ulje e çmimeve. Moratorium i çmimeve të energjisë dhe ulje e çmimeve të produkteve bazike. 4. Aleancë e pathyeshme me Perëndimin. Kosova në NATO e BE, përfaqësim dinjitoz, partneritet strategjik, siguri kombëtare dhe besueshmëri ndërkombëtare. 5. Pavarësi energjetike për Kosovën. Central i ri me gaz amerikan. 6. Kosova e lidhur përmes infrastrukturës rrugore. Përfundimi i autostradave dhe magjistrave brenda mandatit. 7. Dhjetëramijëra vende të reja pune. Investitor strategjik në ICT dhe ekonomi digjitale. 8. Mbështetje për familjen, me ligj. Shtesa të garantuara për fëmijë, lehonat, gra kujdestare dhe pensionistë. 9. Spital i ri i Kosovës. Kujdes shëndetësor modern e dinjitoz. 10. Mësim tërëditor për fëmijët tanë. Në secilën komunë të Kosovës.

Ndërsa Vjosa Osmani ka folur unitet kombëtar dhe rikthim të rugovizmi. “Politika që nxit urrejtje, përçarje dhe frikë duhet t'i takojë së kaluarës”, ka thënë ajo, duke paralajmëruar se zgjedhjet e 7 qershorit nuk janë vetëm garë mes partive, por

“zgjedhje mes dy vizioneve për shtetin”.

Aleanca zotohet se do ta nxjerrë Kosova nga kriza

Edhe Aleanca e ka hapur zyrtarisht fushatën zgjedhore. Kjo parti ka zgjedhur Gjakovën për ta nisur betejën për zgjedhjet e 7 qershorit. Në tubimin e parë të fushatës elektorale ka marrë pjesë edhe ish-kryetari i partisë, Ramush Haradinaj, i cili ka shprehur mbështetje të plotë për kandidatin e Aleancës për kryeministër, Ardian Gjini. Haradinaj e ka cilësuar Gjinin një ndër njerëzit më të aftë për ta udhëhequr vendin, duke shtuar se ai do ta përfaqësojë me dinjitet Kosovën. “Kosova nuk është mirë. Secili prej nesh duhet të bëjë më të mirën për ta nxjerrë nga kjo gjendje. Unë besoj se e kam bërë më të mirën, sepse me zemër, me bindje dhe me shpirt ia kam besuar njërit prej njerëzve më të zotë që njoh për kandidat për kryeministër, Ardian Gjinin”, është shprehur Haradinaj.

Ai e ka kritikuar qeverisjen aktuale, duke thënë se qytetarët nuk duhet të përballen me, siç i quajti ai, “metoda komuniste të mbijetesës”. “Mbas kaq dekadash që jemi të lirë, nuk duhet të pranohet metoda komuniste të mbijetesës. Janë metoda komuniste, por jo komunizëm i ndonjë sistemi të avancuar, janë metoda që na kthejnë mbrapa. Ne nuk duhet të jetojmë me këto metoda. Na duhet mirëqenie që buron nga të ardhura dhe nga një pagë dinjitoze. Nuk janë rritur pagat në sektorin publik, nuk janë rritur pensionet, nuk është rritur mbështetja sociale që i takon secilit me të drejtë”, u shpreh Haradinaj.

Kurse Ardian Gjini ka folur për raportet me aleatët ndërkombëtarë, duke kritikuar qasjen e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA).

Sorenseni takohet me Piercen, në fokus dialogu Kosovë - Serbi

PRISHTINË, 29 MAJ - I dërguari special i Bashkimit Evropian për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Peter Sorensen, ka zhvilluar takim me të dërguarën speciale të Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Dame Karen Pierce, ku janë diskutuar zhvillimet në procesin e dialogut dhe perspektiva e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Përmes një njoftimi, Sorenseni ka bërë me dije se me Piercen kanë biseduar për rëndësinë e angazhimit të vazhdueshëm diplomatik në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi si dhe për domosdoshmërinë e ruajtjes së ritmit të procesit që synon arritjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për normalizim.

Ai ka theksuar se Bashkimi Evropian dhe Mbretëria e Bashkuar ndajnë objektivat

përbashkët për avancimin e procesit të normalizimit dhe stabilitetit në rajon, duke vlerësuar koordinimin ndërmjet partnerëve ndërkombëtarë si element kyç për suksesin e dialogut.

Takimi vjen në një periudhë kur dialogu Kosovë - Serbi mbetet në fokus të diplomacisë ndërkombëtare, me thirrje të vazhdueshme për shtimin e përpjekjeve për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare.



FETOSHI: SERBIA SYNON TA MINOJË DEMOKRACINË NË KOSOVË DHE TA KONTROLLOJË VOTËN E SERBËVE PËRMES LISTËS SERBE



PRISHTINË, 29 MAJ - Drejtori i Përgjithshëm i Institutit "OCTOPUS", Arben Fetoshi, ka paralajmëruar se procesi i ardhshëm zgjedhor në Kosovë mund të përballlet me ndërhyrje të jashtme, dezinformim, presione politike dhe kërcënime hibride, duke theksuar se integriteti zgjedhor duhet të shihet si pjesë e sigurisë kombëtare. Në "Përballje Podcast" në "Telegrafi.com", Fetoshi tha se ndërhyrjet në proceset zgjedhore janë bërë gjithnjë e më shqetësuese, sidomos në kontekstin e luftës hibride dhe qëllimeve të aktorëve që synojnë destabilizimin e demokracive. "Proceset zgjedhore janë target i aktiviteteve ndërhyrëse malinje, për shkak se ato përfaqësojnë ndoshta dimensionin më vital të funksionalitetit të

demokracisë", deklaroi Fetoshi gjatë diskutimit me kryeredaktorin e "Telegrafi"-t, Muhamet Hajrullahu. Sipas tij, në rastin e Kosovës rreziku është edhe më specifik për shkak të raportit me Serbinë dhe përpjekjeve të vazhdueshme të Beogradit për të ndikuar në zhvillimet politike dhe institucionale në vend. "Ndërhyrjet e Serbisë në Kosovë përfshijnë të gjithë ekosistemin, edhe në nivelin politik, edhe në nivelin informativ, edhe në atë të sigurisë", tha ai.

Fetoshi theksoi se një prej objektivave kryesore të Serbisë është kontrolli i përfaqësimit politik të komunitetit serb në Kosovë. "Qëllimi strategjik i Serbisë kundër Kosovës është që të mos e lejojë pluralizmin demokratik të komuniteti serb. Të kontrollojë votën e qytetarëve serbë e cila duhet të

përqendrohet vetëm te Lista Serbe", u shpreh ai. Ai shtoi se, sipas tij, Lista Serbe përfaqëson politikën e Beogradit në Kosovë. "Lista Serbe është subjekt përfaqësues i politikave të Beogradit kundrejt Kosovës", tha Fetoshi.

Duke folur për format e presionit, Fetoshi përmendi shantazhin, kërcënimet, frikësimin, largimet nga puna dhe presionet fizike ndaj rivalëve politikë të Listës Serbe. "Historia e ndërhyrjeve të Serbisë në zgjedhjet në Kosovë është e dhunshme", deklaroi ai. Fetoshi foli edhe për propagandën dhe narrativat që, sipas tij, përdoren nga Serbia kundër Kosovës, duke thënë se ato shpesh synojnë ta paraqesin Kosovën si kërcënim për serbët. "Propaganda serbe është e stërmëshur me fabrikime kinse të incidenteve ndëretnike,

në funksion të narrativës së tyre që regjimi në Prishtinë po angazhohet për ta bërë të padurueshme jetën për serbët në Kosovë", tha Fetoshi. Sipas tij, këto narrativa kanë për qëllim nxitjen emocionale të qytetarëve serbë dhe krijimin e mosbesimit ndaj institucioneve të Kosovës. "Në kuptimin narrativ, ata vazhdimisht kanë përdorur edhe instrumentet e spiunazhit, edhe rrjetet që i kanë këtu", shtoi ai.

Fetoshi tha se Kosova ka nevojë për mekanizma më të fuqishëm institucionalë kundër dezinformimit, duke përmendur nevojën për një qendër nacionale kundër dezinformimit. "Ne kemi insistuar. Ka kohë që Kosova të lëvizë, ashtu siç kanë lëvizur vende të NATO-s, me një Qendër Nacionale Kundër Dezinformimit. Për fat të keq, institucionet nuk kanë lëvizur

në këtë drejtim", deklaroi ai.

Ai theksoi se institucionet duhet të kenë kapacitete më të mëdha për reagim të shpejtë ndaj dezinformatave dhe inskenimeve të mundshme. "Të rriten kapacitetet e institucioneve për t'iu përgjigjur sa më shpejt që është e mundur çfarëdo inskenimi eventual që Serbia tenton të prodhojë", tha Fetoshi.

Duke folur për rolin e medieve, ai tha se sistemi medial në Kosovë ka përgjegjësi të madhe në mbrojtjen e hapësirës informative. "Sistemi i medieve në Kosovë e ka për detyrë të jetë më i kujdesshëm në mbrojtjen e integritetit të hapësirës informative në Kosovë", tha ai. Fetoshi shtoi se mbrojtja e hapësirës informative lidhet drejtpërdrejt me mbrojtjen e zgjedhjeve dhe funksionimin demokratik të vendit.

FSK-ja realizon ushtrimin fushor "Ujku i Pamposhtur 01"

PRISHTINË, 29 MAJ - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ka njoftuar se nga data 31 maj deri më 5 qershor 2026 "Forca e Sigurisë së Kosovës do ta

realizojë ushtrimin fushorë validues "Ujku i Pamposhtur 01".

Gjatë kësaj periudhe do ketë lëvizje të konvojeve nga

vendbanimet e Forcës së Sigurisë së Kosovës në drejtim të rajonit të Gjakovës, saktësisht Aeroportit të Gjakovës dhe poligonit

ushtarak në Babaj të Bokës. E gjithë kjo lëvizje do të bëhet me qëllim të realizimit të ushtrimit, andaj kërkohet mirëkuptim nga qytetarët.



ÇFARË MODELI TË MBROJTJES GJITHËPËRFSHIRËSE KA FINLANDA TË CILIN PO E MERR SHEMBULL KURTI?



PRISHTINË, 29 MAJ - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, tha se është “më e mençur” për vendin që të ketë mbrojtje gjithëpërfshirëse apo totale sesa shërbim të detyrueshëm ushtarak që kishte premtuar kaherë. Në këtë drejtim, gjatë një konference për medie më 28 maj ai përmendi modelin e Finlandës dhe vendeve baltike. “Një model që i ngjan atij të Finlandës dhe vendeve baltike, ku ti nuk e bën ushtrinë një grumbull të madh njerëzish, që mandej duhet ta strukturosh e ta pajisesh, por në vend të kësaj përcakton funksione e detyra konkrete dhe vende të caktuara për qytetarët në rast të rreziqeve të ndryshme nga fatkeqësitë natyrore e deri te lufta e armatosur”, tha Kurti. Kjo nuk është hera e parë që përmendet mundësia e mbrojtjes gjithëpërfshirëse nga qeveria e Kurtit.

Madje në shtator të vitit 2024 ekzekutivi i Kosovës kishte miratuar Programin Kombëtar për Mbrojtje Gjithëpërfshirëse që synon mbrojtjen e shtetit nga kërcënimet, sulmet dhe fatkeqësitë natyrore. “Qëndrueshmëria kombëtare” synohet që të ndërtohet me këtë program, në mënyrë që shoqëria e Kosovës të përgatitet “të rezistojë, të reagojë e të rimëkëmbët në raste të fatkeqësive natyrore, apo sulmeve të armatosura”. “Sistemi ka në thelb mbështetjen që qytetarët ia japin në baza vullnetare ushtrisë sonë, FSK-së, por edhe të kombinuar me strukturat e tjera shtetërore”, deklaroi atëherë Kurti.

Afërsisht dy vjet më vonë Kurti

tha se ky model i mbrojtjes totale shoqërohet edhe me aspekte të tjera, përkatësisht me një model për shkollat e mesme që quhet “Edukimi për siguri” që, sipas tij, u mundëson të rinjve të mësojnë se si të reagojnë në raste të fatkeqësive natyrore apo konflikteve. “Do ta kemi edhe rezervën vullnetare. Pra, rezerva vullnetare e cila mundëson që qytetarët e Kosovës që do të bëhen rezervistë të FSK-së t’i kenë pajisjet nga çizmet deri tek arma e tyre në një adresë të caktuar në FSK. Unë besoj se kjo çfarë po bëjmë është shumë më mirë sesa shërbimi i detyrueshëm ushtarak”, tha Kurti më 28 maj.

Kur për herë të parë u përmend si ide mbrojtja gjithëpërfshirëse, drejtori i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë, Mentor Vrajolli, i tha Radios Evropa e Lirë se kjo nënkuptonte edukimin e qytetarëve për mbrojtje, pa përfshirë as stërvitjet praktike. Megjithatë, Vrajolli deklaroi se pa shërbim të detyrueshëm ushtarak nuk do të mund të funksiononte as koncepti i mbrojtjes gjithëpërfshirëse. “Këto të dyja mendoj se janë të pandashme nga njëra-tjetra. Nëse ato nuk bashkohen me njëra-tjetrën, atëherë mendoj se të dyja janë thuajse të pazbatueshme”, u shpreh ai. Por, çfarë është doktrina e mbrojtjes totale që ka Finlanda, në të cilën u thirr Kurti?

Finlanda, shtet në Evropën Veriore që ndan një kufi të gjatë me Rusinë, për vite të tëra ka në fuqi strategji kombëtare të mbrojtjes. Doktrina e mbrojtjes totale e Finlandës njihet me

emrin Koncepti i Sigurisë Gjithëpërfshirëse, e cila në thelb është strategji për mobilizimin e gjithë shtetit në rast lufte. Ndërkaq, ky vend që është anëtar i NATO-s ka edhe Strategjinë e Sigurisë për Shoqërinë, që është një evolucion i doktrinës fillestare, përkatësisht është një koncept që ka një qasje gjithëpërfshirëse të shoqërisë në krizat ushtarake dhe joushtarake, siç mund të jenë fatkeqësitë natyrore apo edhe sulmet kibernetike.

“Parimi i mbrojtjes totale të Finlandës nënkupton që mbrojtja jonë varet nga mbështetja e fuqishme nga shoqëria”, tha ministri finlandez i Mbrojtjes, Antti Hakkanen, pas miratimit të një raporti qeveritar të mbrojtjes në dhjetor të vitit 2024.

Modeli i Helsinkit për mbrojtjes ka disa shtylla kyçe, sikurse është shërbimi i detyrueshëm ushtarak dhe rezervistët, trajnimi i qytetarëve për reagim gjatë emergjencave dhe krizave, bashkëpunimi mes shtetit dhe shtyllave të tjera shoqërore, sikurse bizneset, luftimi i definformimit, luftimi i sulmeve kibernetike dhe operacioneve hibride.

Finlanda e vlerëson themel të qëndrueshmërisë së shoqërisë së saj sigurinë gjithëpërfshirëse. Ky koncept është vital për funksionimin e shoqërisë dhe bëhet në bashkëpunim mes autoriteteve, komunitetit të bizneseve, organizatave dhe qytetarëve “në të gjitha rrethanat dhe në të gjitha nivelet”.

Veprimet strategjike, sipas doktrinës, janë një sërë detyrash që bazohen në ligje dhe të

formalizuara përmes marrëveshjeve dhe të shoqëruara me aktivitete vullnetare. “Kryerja e detyrave në të gjitha situatat e sigurisë kërkon përgatitje dhe përgjigje - me fjalë të tjera, masa për t’u përgjigjur ndaj kërcënimeve”, thotë Komiteti për Siguri i Ministrisë së Mbrojtjes të Finlandës.

Ky komitet thotë se përgatitjet e shoqërisë për raste të ndryshme zvogëlojnë mundësinë që rreziqet të jetësohen.

Individët janë “aktorë kyçë në shoqëri. Ata kanë të drejtë kushtetuese për siguri, po ashtu përgjegjësi që të veprojnë në bazë të aftësive të tyre në atë mënyrë që ta rrisin sigurinë në komunitete dhe shoqëri. Respekti i ndërsjellë mes njerëzve është element vital për mbajtjen e shoqërisë”, thotë Komiteti.

Koncepti 72-orësh

Siguria e Finlandës mbështetet në shërbimin e detyrueshëm ushtarak për të gjithë burrat nga mosha 18-vjeçare, të cilët, në rast të një agresioni ushtarak, do të përfshiheshin në luftë.

Përgatitja e shoqërisë për raste të ndryshme, përfshin trajnime të ndryshme, teksa shteti ka infrastrukturë për mbrojtje civile, përfshirë vendstrehime për sulme me bomba apo sulme bërthamore. Ky shtet ka kapacitet që të strehojë mbi 80 për qind të popullatës në vendstrehime, nëse është e nevojshme.

E gjithë shoqëria përgatitet në mënyrë aktive që ta mbështesë ushtrinë, nëse nevojitet, teksa mbajtja e moralit lartë të qytetarëve shihet si element kyç i

qëndrueshmërisë së shoqërisë. Një tjetër aspekt është edhe që në rast të krizave Finlanda të mos paralizohet, në kuptimin që të ketë rezerva të mjaftueshme të produkteve kyçe ushqimore, shëndetësore, rezerva të karburanteve etj.

Shembull, në Finlandë, sipas Komitetit për Siguri, është edhe koncepti 72-orësh. Sipas këtij koncepti, qytetarët rekomandohet të kenë furnizime të mjaftueshme ushqimore, pajisje mjekësore në rast se ka ndërprerje të gjata të energjisë elektrike që do të shkaktonin pengesa në ofrimin e shërbimeve. “Familjet duhet të përgatiten që t’ia dalin vetë për të paktën tri ditë nëse ndodh kjo. Ata duhet të kenë furnizime ushqimore për tri ditë dhe ilaçe”, thuhet në një njoftim të Komitetit.

Pra, në thelb, kjo doktrinë e mbrojtjes gjithëpërfshirëse e Finlandës parasheh që qytetarët të jenë të trajnuar se si të reagojnë në raste të ndryshme të fatkeqësive natyrore, rreziqeve të tjera apo të luftës dhe ta mbështesin shtetin në rast nevojë.

Doktrina e mbrojtjes totale në Finlandë u dizajnuar gjatë Luftës së Ftohtë për t’u siguruar që vendi mund t’i bënte ballë një agresioni nga një armik më superior përmes kombinimit të parandalimit ushtarak përgatitjes civile, qëndrueshmërisë ekonomike dhe qëndrueshmërisë psikologjike të qytetarëve.

Në dritë të pushtimit rus të Ukrainës, Finlanda u anëtarësua në NATO më 4 prill të vitit 2023.

Guvernatori Ismaili: BQK-ja transferon afër 38 milionë euro për buxhetin e shtetit në tri vitet e fundit

PRISHTINË, 29 MAJ - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Ahmet Ismaili, ka njoftuar se BQK-ja ka miratuar pasqyrat financiare vjetore për vitin 2025, të audituara nga auditori i jashtëm i pavarur me opinion të pastër, pa kualifikim, duke konfirmuar stabilitetin financiar, transparencën dhe standardet e larta të qeverisjes institucionale. Në fokus të rezultateve financiare për vitin 2025, guvernatori Ismaili ka veçuar

kontributin e vazhdueshëm të BQK-së për financat publike, përmes ndarjes së të ardhurave për buxhetin e shtetit për të tretin vit radhazi. Sipas rezultateve financiare, ai nëpërmjet një njoftimi tregon se BQK-ja ka realizuar të ardhura neto prej 24 milionë eurosh për vitin 2025, nga të cilat 12 milionë euro do të transferohen në buxhetin e shtetit, ndërsa pjesa tjetër do të alokohet në rezervat e përgjithshme të Bankës

Qendrore në përputhje me Ligjin për BQK-në. Me këtë transferim vlera totale e mjeteve të ndara nga BQK-ja për buxhetin e shtetit gjatë tre viteve të fundit arrin rreth 38 milionë euro, duke reflektuar performancën e qëndrueshme financiare dhe menaxhimin e kujdesshëm institucional të BQK-së. "Ky është viti i tretë radhazi që BQK ndan të ardhura për buxhetin e shtetit, duke e çuar vlerën totale të transferimeve në afër 38

milionë euro", thuhet në njoftimin e guvernatorit Ismaili. Më tutje, ai theksoi se ky rezultat dëshmon përkushtimin e BQK-së ndaj stabilitetit financiar, llogaridhënies dhe mbështetjes së qëndrueshme për financat publike të vendit krahas forcimit të rezervave dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të institucionit. Në fund ai vlerësoi se opinioni i pastër i auditorit të jashtëm përbën konfirmim të cilësisë



së raportimit financiar dhe të standardeve të avancuara të transparencës dhe qeverisjes brenda BQK-së.

KUSARI-LILA PARAQITI PESË PRIORITETET E KOSOVËS NË TAKIMIN E CEFTA-S NË BRUKSEL

PRISHTINË, 29 MAJ - Ministrija e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, Mimoza Kusari-Lila, mori pjesë në takim ministror të CEFTA-s të mbajtur në Bruksel, takim i cili këtë vit u kryesua nga ministrija e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit e Shqipërisë, Delina Ibrahimaj, pasi Shqipëria mban kryesimin e CEFTA-s gjatë vitit 2026.

Në adresimin e saj para përfaqësuesve të vendeve anëtare të CEFTA-s, Kusari-Lila tha se Kosova e mirëpret mundësinë për të diskutuar hapur për arritjet dhe sfidat e procesit të CEFTA-s, duke theksuar se integrimi gradual në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian duhet të jetë më shumë sesa vetëm një zotim në dokumente.

Ministria rikujtoi se edhe para 15 vjetësh, gjatë mandatit të saj të parë si ministre e Industrisë dhe Tregtisë, kishte ngritur shqetësime për mangësitë në funksionimin e CEFTA-s, duke shtuar se disa nga ato probleme vazhdojnë të jenë ende të pranishme. Ajo theksoi se Kosova ka dëshmuar seriozitet dhe qasje konstruktive gjatë kryesimit të CEFTA-s në vitin 2025, duke avancuar Planin e Veprimtimit për Tregun e Përbashkët Rajonal, nismën Green Lanes, Strategjinë e Menaxhimit të Rrezikut, njohjen e shërbimeve elektronike të besimit dhe Programin e Operatorit Ekonomik të Autorizuar. Sipas saj, për herë të parë Kosova kryesoi CEFTA-n në



emrin e saj dhe jo përmes UNMIK-ut, duke e përdorur këtë mandat për ndërtim bashkëpunimi dhe jo për krijim pengesash politike. Kusari-Lila bëri me dije se Kuvendi i Kosovës ka ratifikuar Protokollet Shtesë 5, 6 dhe 7 të CEFTA-s për lehtësimin e tregtisë, tregtinë e shërbimeve dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke kërkuar që të gjitha palët të tregojnë të njëjtin përkushtim institucional. Ajo tha se për Kosovën CEFTA nuk është një koncept abstrakt, pasi vendimet që merren në këtë mekanizëm ndikojnë drejtpërdrejt te bizneset, eksportuesit dhe qytetarët e vendit. Sipas të dhënave të paraqitura nga

ministrja, gjatë vitit 2025 tregtia e jashtme totale e Kosovës ka arritur në 7.9 miliardë euro, ndërsa eksportet drejt vendeve të CEFTA-s kanë arritur në 431.5 milionë euro, ose 45.8 % të eksporteve totale të vendit. Në fjalimin e saj, ministria ngriti shqetësimin për barrierat tregtare dhe politizimin e proceseve brenda CEFTA-s, duke theksuar se marrëveshjet e tregtisë së lirë duhet të shërbejnë për heqjen e pengesave dhe jo për krijimin e tyre. Ajo paralajmëroi se, në mungesë të përgjigjeve konkrete ndaj barrierave të fundit tregtare, Kosova mund të shqyrtojë masa reciproke. Gjatë takimit Kusari-Lila paraqiti pesë prioritetet

kryesore të Kosovës në kuadër të CEFTA-s. Prioriteti i parë kishte të bënte me njohjen e vlerësimit të konformitetit dhe infrastrukturën e cilësisë. Ministria theksoi se Kosova mbështet vetëm mekanizma që janë plotësisht në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, duke kundërshtuar krijimin e sistemeve paralele që devijojnë nga standardet evropiane. Si prioritet të dytë ajo përmendi harmonizimin e procedurave kufitare dhe të orarit të punës në pikat kufitare si dhe avancimin e shkëmbimit elektronik të certifikatave veterinarë dhe fitosanitare me qëllim të lehtësimit të tregtisë rajonale

dhe uljes së pritjeve në kufi. Prioriteti i tretë lidhej me tregtinë e shërbimeve, njohjen e kualifikimeve profesionale dhe harmonizimin e procedurave për lejet e punës. Kusari-Lila tha se tregu i përbashkët rajonal nuk mund të jetë funksional pa lëvizje më të lirë të profesionistëve dhe shërbimeve ndërmjet vendeve të rajonit. Në kuadër të prioritetit të katërt, ministria kërkoi hyrjen në fuqi të Protokollit Shtesë 7 për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke vlerësuar se mungesa e një mekanizmi funksional po ndikon negativisht në besueshmërinë e CEFTA-s. Ndërkaq, prioriteti i pestë kishte të bënte me tregtinë digjitale dhe avancimin e njohjes së shërbimeve elektronike të besimit sipas standardeve eIDAS 2.0 të Bashkimit Evropian si dhe krijimin e mekanizmave të alarmit të shpejtë për produktet jokonforme dhe sigurinë ushqimore. Ministria theksoi se Kosova ka ardhur në këtë takim me protokolle të ratifikuara, me rezultate konkrete nga kryesimi i CEFTA-s dhe me infrastrukturë funksionale kufitare, duke kërkuar seriozitet reciprok dhe zbatim të marrëveshjeve nga të gjitha palët. Ajo tha se Tregu i Përbashkët Rajonal dhe integrimi gradual në Tregun e Vetëm të Bashkimit Evropian ndërtohen përmes vendimeve konkrete, zbatimit të zotimeve dhe vullnetit politik të përbashkët.

ZKA-ja pjesë e programit studimor në Holandë për menaxhimin dhe auditimin e fondeve të BE-së

PRISHTINË, 29 MAJ - Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca dhe auditorët Donjeta Dreshaj dhe Vjosë Zeqiraj, morën pjesë në programin studimor më 20 dhe 21 maj 2026 në Hagë të organizuar nga Akademia Kombëtare për Financa dhe Ekonomi dhe Ministria e Financave e Holandës.

Programi studimor pati për fokus monitorimin, vlerësimin, auditimin dhe sigurimin e zbatimit të Agjendës së Reformave dhe integritetit të

fondeve të Bashkimit Evropian, duke mundësuar shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse. Gjatë programit dyditor pjesëmarrësit u njoftuan me sistemin e menaxhimit të fondeve të BE-së në Holandë, proceset dhe mekanizmat e kontrollit dhe auditimit, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve relevante në menaxhimin dhe mbikëqyrjen e këtyre fondeve.

Më tej u trajtuan edhe temat që lidhen me Planin e Rimëkëmbjes dhe Qëndrueshmërisë së Holandës, fondet strukturore dhe fondet bujqësore, me theks të veçantë në proceset e menaxhimit, kontrollit, auditimit, monitorimit dhe raportimit. Auditorja e Përgjithshme, Vlora Spanca, ka deklaruar se ky shkëmbim i përvojave riafirmon rëndësinë e kornizave të fuqishme të kontrollit të brendshëm dhe të

strukturave të përcaktuara, të llogaridhënies si elemente thelbësore për mbrojtjen e parasë publike si dhe për forcimin e besimit në menaxhimin e programeve të financuara nga Bashkimi Evropian. Ajo shtoi se aktiviteti do të shërbejë si udhërrëfyes në përpjekjet e mëtejshme për ta forcuar cilësinë e auditimit, për ta thelluar përafrimin me standardet evropiane si dhe për ta fuqizuar rolin e auditimit të



jashtëm në mbështetje të llogaridhënies dhe qeverisjes së mirë financiare.

FULVIA DOLLMENI SHTËPANI: ALI PASHA U VRA. POR KUSH E FITOI HISTORINË?

Vdekja e Ali Pashë Tepelenës – Midis historisë dhe mitit

Mund të sjelli vdekja pavdekësinë? Rrallë herë po.... Vdekja e një figure si Ali Pashë Tepelena, solli lindjen e një miti.

Vdekja për të, nuk ishte humbje, të dorëzohej, po.

Edhe kur koka bie, njeriu që ka zgjedhur të bëj ç'ka dashur përherë, mbetet në këmbë.

Asgjë nuk është e sigurt, përveç gjestit final.

Historia shkruhet me tehe, miti me jehonë dhe kujtesë. Ali Pashë Tepelena nuk u largua, nuk u lut.

Ai zgjodhi! Midis dorës së xhelatit dhe heshtjes, Ali Pasha zgjodhi heshtjen.

Një shkrepëtimë përfytyrimi imagjinari, më ngacmon e vazhdon të formësohet si pasqyrim i një gjesti simbolik, si flijimi i fundit i një njeriu të papërkulur.

Po sikur ta kishte paraprirë tehen e shpatës që do ti priste kokën? Po sikur, në çastet e fundit të jetës, ta kishte vendosur vetë dorën e tij, aty ku pritej ajo e Perandorisë? Jo nga dëshpërimi, por nga sovraniteti.

T'ia ofrosh kokën heshtjes, më mirë sesa kënaqësinë së armikut. T'ia heqësh atij kënaqësinë e shijimin të gjestit ndëshkues, ngadalësinë mizore të triumfit. Kjo nuk do të ishte vetëvrasje, por një akt i fundit urdhërimi!! Një urdhër i fundit, i dhënë vetë vdekjes!!

Kështu, ai nuk do të ishte më një trup i dorëzuar, por një vullnet i pamposhtur, që heshturazi duket sikur thoshte: Mund t'i merrni kokën njeriut që vdes, por jo atë, për të ç'ka ai vendos.

Gjaku do të rridhte duke vetëvulosur çastet e fundit të fatit të tij, por jo dorëzimin para sulltanit.

Dhe historia, e turbulluar, do të hezitonte të pranonte kush fitoi: ai që pret, apo ai që zgjedh çastin?!

Atë ditë, Ali Pashë Tepelena nuk humbi kokën, ai ja ktheu tokës së tij, të lirë, para se t'ia vidhnin! Nuk është koka që bie, është frika që tërhiqet.

Perandoria fiton një trofe, Toka mirëpret në gjirin e saj një sovran!! Kwta burra qw edhe kur trupi i dorëzohet vdekjes, vullneti mbetet.

Pikërisht aty kujtesa bëhet trashëgimni, e jo legjendë sterile.

Me rastin e përvjetorit të vdekjes së Ali Pashës, do të doja t'i rikthej diçka simbolike.

Një dinjitet epiko-poetik, pa mohime e iluzione, pa shmangie e vetëmburrje, por thellësisht njerëzor.



Të flasësh për Ali Pashë Tepelenën, kur je me origjinë shqiptare, do të thotë të refuzosh klishetë dhe karikaturat e sajua për të, nga Evropa Perëndimore. Nuk do të thotë të justifikosh egërsinë, as të fshish dritë-hijet e personalitetit, por të pranosh kompleksitetin e tij, atë të vërtetë të ashpër, nga ku lindin gjithëherë figurat e mëdha historike.

E kanë reduktuar në një tiran pa zemër, në një plak obez dhe dinak, sikur koha të mund të fshinte mprehtësinë e vështrimit, besën e fjalës së dhënë, hijen e një njeriu që dinte të komandonte pa iu dridhur syri dhe dora.

Ali Pasha ishte edhe një burrë i bukur në kuptimin e typareve fiziko-morale antike: vështrim penetrues, hije-rëndë e i palëkundshëm, ai që mban fjalën, që merr përsipër, që nuk tërhiqet, kur vjen ora për të paguar edhe me çmimin e jetës.

Për Perandorisë Osmane, ai

nuk është vetëm rebel apo strateg, por njeriu që u ngrit dhe guxoi ta sfidojë atë.

Ai mishëron një rezistencë mbase jo shumë të organizuar, por të vetëdijshme, një fljirim të kthjellët: "Më mirë të vdesësh në këmbë sesa të jetosh i gjunjëzuar".

Fundi i tij, në një prag të hidhur dimri, nuk është ai i një përbindëshi të zbratur nga shpirti, por i një njeriu, që pranon të vetësakrifkohet, për të mos u dorëzuar.

Jam e vetëdijshme se trashëgimia e tij nuk është e kulluar, por është e denjë tw njihet.

Ai i la Shqipërisë një mësim disi të ashpër, por të domosdoshëm!

Atë të guximit politik, të autonomisë së ëndërruar, të identitetit të proklamuar për t'i shpëtuar zhdukjes.

Ali Pasha nuk është figurë e shenjtë, por për shqiptarinë ai është më kompleks dhe njëkohësisht, më i çmuar se një shenjt, pasi arriti të kthehet

në një simbol.

Megjithëse njihet si një personalitet i dyzuar, kujtesa e tij vazhdon të na pëshpërisë, se liria lind shpesh në rebelim, në luftë dhe në gjak, por kurrë në nënshtrim.

Përpiqem me gjithë forcën time të përfytyroj monologun e tij të brendshëm në prag të vdekjes. Po sikur ta kishte prerë vetë kokën e tij? Çfarë do të kishte ndjerë në çastet e fundit?

Monolog imagjinari – (pëshpërim) Ali Pashë Tepelena:

– Eh.. rrethimi po ngushtohet, aventurës time të quajtur jetë, po i vjen fundi! Të ftohtit po më kafshon kockat... Përpiqem që mendja ime të rri ende zgjuar. Kam nevojë për të. Është e vetmja që nuk më ka tradhëtuar kurrë!
-Më duan në gjunjë osmanllinjë, por unë do të qëndroj në këmbë, deri në fund!!

-Vetetë e kam dashur pushtetin, nuk e mohoj..., por tokën time, vëndin tim, e kam dashur edhe më shumë.

-Ah ju gurët e mi, malet e mia, heshtja juaj e ashpër më përkundi që në djep... Ajo më mësoi të mos përkulem kurrë.

-Do të thonë për mua se kam qenë mizor. Por harrojnë sa ashpërsi duhet për të ndalur shkatërrimin e për të mbrojtur dinjitetin.

-E mbajta fjalën për të cilën isha betuar, edhe kur fjala kish çmimin e jetës.

-Shpesh kam qenë i vetëm, i tradhtuar gati përherë, por kurrë bosh, se ndjenja e pavarësisë më mbushte.

-Nuk është vdekja që më tremb, është harresa!! Nuk kam qenë « askushi ». Nëse bie sot, le të bie siç bien burrat e mëdhenj. Me kokën lart, emrin të panjollësuar, vullnetin e padiskutueshëm.

-Le të ma marrin kokën. Por mendimet e veprimet e mija, nuk do t'i përvetësojnë dot kurrë!

Ideja ime e të qenit i lirë nuk njeh vdekje. Edhe një njeri i vetëm, edhe i rrethuar nga Perandoria më e fuqishme, mund të thotë jo, dhe ta shndërrojë këtë jo në trashëgimi.

-Jo, jo Ali Pashë Tepelena nuk është mundur, ai ka vendosur të iki për të mos u gjuhëzuar, për të mos rënë në duart e armiqve ugurzinj.

-Unë po iki, por toka do të më kujtojë.

Frika vdiq para tij!! Aty ku historia hesht, miti fillon !

Pushteti, precedenti dhe frika pas vdekjes. Ali Pashë Tepelena dhe ankthi i sovranitetit

Kur Perandoria Osmane përfaqësuar nga Mahmud II, kërkon të shohë kokën e prerë të Ali Pashë Tepelenës, ajo nuk kërkon vdekjen e tij, por sigurinë e saj.

Frika e Sulltan Mahmud II ndaj Ali Pashë Tepelenës nuk përfundon me vdekjen e këtij të fundit. Ajo vazhdon, pikërisht, pasi vdekja nuk e ka zgjidhur problemin që Ali Pasha kishte hapur. Në këtë kuptim, kërkesa për të parë kokën e prerë, nuk është një akt hakmarrjeje, por një akt sovraniteti.

Siç do të sugjeronte Carl Schmitt, sovraniteti është ai që vendos mbi përjashtimin. Ali Pasha kishte krijuar një përjashtim të rrezikshëm, jo duke sfiduar drejtpërdrejt ligjin, por duke treguar se rendi mund të funksiononte edhe jashtë tij.

Ai arriti të realizoj demonstrimin konkret të një mundësie strukturore për një pushteti alternativ të pavarur. Ky sukses e shndërronte atë në precedent, dhe precedenti përbën një kërcënim shumë më të madh sesa rebelimi i hapur.

Pushteti perandorak nuk përballet më me një individ, por me një mundësi strukturore. Prandaj eliminimi fizik nuk mjafton. Koka e prerë bëhet e nevojshme si provë materiale e rivendosjes së sovranitetit.

Nga perspektiva e Michel Foucault, ky akt duhet lexuar si një përdorim politik i qëllimshëm i trupit fizik. Ekspozimi i trupit të shkatërruar, “kokës së prerë”, synon të prodhojë një efekt disiplinues mbi shikuesin. Trupi nuk zhduket, por shndërrohet në tekst politik, në mesazh të dukshëm të pushtetit.

Ky gjest zbulon brishtësinë e autoritetit absolut. Pushteti që ka nevojë të ekspozojë dhunën e tij është një pushtet që ndien pasiguri.

Ali Pashë Tepelena, edhe pas vdekjes, mbetet i pranishëm si figurë konceptuale, si simbol që e sfidoi hegjemoninë e

kontrollit perandorak. Ky gjest zbulon paradoksin e vetë pushtetit absolut: ai është i fortë vetëm për aq kohë sa nuk detyrohet të dëshmojë forcën e tij. Momenti kur sovraniteti kërkon prova materiale të bindjes, është momenti kur autoriteti i tij shfaqet i brishtë.

Në sensin simbolik, koka e prerë e Ali Pashës, nuk shënon fundin e rrezikut, por njohjen e tij. Ajo dëshmon se pushteti nuk frikësohet nga trupat e pajetë, por nga ajo që mbijeton përtej tyre: kujtesa, modeli, miti.

Ali Pashë Tepelena e kishte mundur perandorinë ! Edhe i vdekur, vazhonte të ekzistonte si problem teoriko-ekzekutiv thelbësor. Ai kishte kaluar nga historia në koncept, nga fakt në simbol. Dhe simboli nuk mund të ekzekutohet. Fakti historik shndërrohet në mit politik !!

Ali Pashë Tepelena: Mes figurës, mitit dhe projekcionit....

Në tabllonë e Alexandre-Gabriel Decamps, imazhi i Ali Pashë Tepelenës pranë “skllaves së krishterë” Kyra Vassiliki (Vasiliqi) nuk është aspak i rastësishëm. Nuk bëhet fjalë për një skenë të thjeshtë intime, por për një figurë të ngarkuar me simbole, tensione dhe dhe fantazi kulturore projektioneve evropiane. Nuk ekziston asnjë fotografi autentike e Ali Pashës dhe Vasiliqisë së bashku, pasi ndodhemi përpara përdorimit të fotografisë.

Çfarë mund të shohim sot janë piktura, gravura apo përfaqësime romantike evropiane (shpesh të realizuara pas vdekjes së tyre). Me fjalë të tjera imazhet e tabllave të atëhershme tregojnë po aq për Evropën, sa edhe për vetë personazhet.

Tablloja e Ali Pashë Tepelenës me Vasiliqinë, përfaqëson në vetvete vështrimin evropian të lëkundur mes ekzotizmit dhe fantazisë. Nuk është një tablo që tregon realitetin, por një dëshirë për ta formësuar atë, me anën e një imazhi që tregon atë që dëshirohet të besohet.

Dihet se një pikurë nuk është kurrë « neutrale ». Kjo pikurë nuk është as dëshmi, as një çast i kapur në mënyrë spontane. Ajo është një « skenografi ideologjike ».

Ajo pasqyron vështrimin e artistit, pritshmëritë e publikut evropian, fantazitë e kohës mbi Orientin dhe mënyrën se si dëshirohej të përfshihej Ali Pasha, brenda një narrative të caktuar. Ajo nuk dëshmon për Ali Pashën, por rrëfen për të.

Nga një lexim i thjeshtë i kësaj tabllaje mund të imagjinojmë Ali Pashë Tepelenën, zotin e maleve dhe humnerave, ulur në skajin e fatit, aty ku koha thyhet. Ai mban në vështrimin

e tij, vrazhdësinë e betejave, peshën e tradhtive, pëçarjen e perandorisë së tij të brëndshme dhe mallkimin e pushtetit që ha vetveten. Dora e tij ende shtrëngon shpatën e pushtetit, si një relike e një bote që po perëndon, ndërsa shpirti i tij, tashmë, lëkundet diku tjetër... Vasiliqia, afrohet si një frymë që guxon të prekë të pathyeshmen, jo si një grua, por si një hije e bardhë, jo dashuri, por ogur.

Gishti i saj nuk urdhëron, nuk lutet, por zgjon. Në lakuriqësinë e saj të heshtur, fshihet sekreti i asaj, që as dhuna, as froni, nuk mund ta mbajnë.

Gjesti i saj është i lehtë, si një ledhatim i varur mes frikës dhe dashurisë. Ajo nuk e sfidon forcën: e zbut.

Ajo nuk flet : çarmatos.

Në lakuriqësinë e brishtë të shpatullës së saj përqendrohet gjithçka që dhuna e botës nuk ka ditur kurrë ta zotërojë. Mes tyre nuk ka as paqe, as luftë, por një armëpushim, një hapësirë e shenjtë – pa emër... Një çast i vjedhur nga Historia. Ali Pashë Tepelena, figurë hekuri dhe zjarri, ndien se perandoria e tij lëkundet në kontakt me këtë butësi. Perandoria përkulet jo nga forca, por nga butësia. Jo nga armët, por nga një vështrim...

Vasiliqia, e re, e bukur dhe e heshtur, e parandien tashmë se dashuria nuk i shpëton tiranët, por ua zbulon vetminë. Perdet e errëta rëndojnë si qiell i mbyllur

Orienti i idealizuar shndërrohet në teatër të tragjikes njerëzore, nuk është më vend, por ëndërr e errët, fillimi i rënies. Aty pushteti sheh fytyrën e vet të vdekshme dhe dridhet. Ky nuk është një takim, është një shenjë, një çast ku sundimtari bëhet trup, dhe hijeja bëhet fat...

Fati i Ali Pashës, i këtij burri të fuqishëm, por të ftohtë, dominues, por të mbyllur, me një pushtet madhështor e autoritar të rrethuar nga luksi, por të privuar nga ngrohtësia e intimitetit, është i çuditshëm. Megjithatë dokumentacioni i epokës është i kufizuar, njihen disa elemente reale, por ato janë të rralla, fragmentare dhe shpesh të filtruar nga vështrime të jashtme. Pikërisht, kjo e bën marrëdhënien e Ali Pashës me Vasiliqinë, sa të vështirë për t'u kapur dhe po aq interesante.

Ajo që është e vërtetuar historikisht është ekzistenca e një marrëdhënieje të qëndrueshme. Është e njohur se Ali Pashë Tepelena ka mbajtur një lidhje të qëdrueshme me Vasiliqinë, një e re e krishterë greke me origjinë çame nga Plesivica, sot Plaisio. Ndryshe nga imazhi i robëreshës kalimtare, ajo qëndroi për shumë vite pranë tij, nuk u përzu, dhe mbeti e pranishme deri në rënien e Ali

Pashës. Kjo kohëzgjatje është një tregues i fortë për një harem apo një rreth pushteti në atë kohë.

Qëndrueshmëria nënkupton diçka autentike. Vasiliqia nuk u konvertua në islam, ajo mbeti e krishterë (kjo është e dokumentuar tashmë). Ali Pasha i lejoi asaj të praktikonte fenë e saj, të ruante emrin dhe identitetin e veçantë. Për një pasha të rangut të tij, kjo nuk ishte as e zakonshme, as e parëndësishme. Kjo tregon një marrëdhënie që shkon përtej posedimit të thjeshtë.

Me të dhënat historike që disponohen, Vasiliqia mund të konsiderohet si një ndikim real, por i heshtur. Disa burime tregojnë se ajo ndërhynte për të burgosur të krishterë, zbuste disa vendime, mbronte familje të posaçme apo komunitete, restauront ekisha (rreth 40). Ajo nuk kishte pushtet zyrtar, por ushtronte një ndikim informal, tipik për rrethet e oborrit.

Nuk kemi të bëjmë me një mit romantik, por me një formë klasike të pushtetit indirekt. Ajo që mund të mendohet dhe që është e mundshme (por jo e dokumentuar drejtpërdrejt) është një lloj marrëdhënieje afektive asimetrike. Asgjë nuk lejon të flitet për “dashuri romantike” në kuptimin modern, por gjithçka tregon një lidhje reale, një besim, një afërsi emocionale të kufizuar, por të qëndrueshme. Ali Pasha nuk ishte njeri rrëfimesh.

Nëse ai e mbajti Vasiliqinë pranë vetes, kjo ndodhi sepse ajo përfaqësonte një prani paqësuese, një stabilitet, një lidhje politikisht jo kërcënuese, një figurë ndërmjetësuese. Ka të dhëna të mundshme që Vasiliqia të ketë shërbyer si urë mes Ali Pashës dhe popullsisë të krishterë, mes pushtetit dhe dhembshurisë, mes dhunës strukturore dhe përjashtimit njerëzor. Kjo shpjegon pse pas vdekjes së Ali Pashës, ajo nuk u persekutua, por u respektua.

Kyra Vasiliki nuk ishte thjesht “skllavja e bukur e dashuruar”. Mendoj se ky imazh është kryesisht një ndërtim perëndimor, i ndikuar nga letërsia romantike, piktura orientaliste dhe rrëfimet moralizuese të kohës. Figura e saj, e krijuar, thjeshton në ekstrem një marrëdhënie komplekse, të pabarabartë, të heshtur, të rrënjësuar në një raport pushteti. Në optikën mitike, kjo tregon më shumë për Evropën e shekullit XIX sesa për vetë Vasiliqinë dhe Aliun.

Kur flitet për heshtje, duhet të kuptohet se nuk ekzistojnë as letra personale, as ditarë intimë, as dëshmi të drejtpërdrejta nga Vasiliqia.

Kjo heshtje nuk është mungesë, por kusht i ekzistencës së grave në këto struktura pushteti. Megjithatë, çfarë mund të thuhet, është se ajo përfaqëson vështrimin evropian mes ekzotizmit dhe fantazisë.

Në imagjinatën perëndimore, kjo tablo përmbush të gjitha klishetë: despoti oriental, vajza e re e krishterë, robëresha që bëhet favorite, erotizmi i mbuluar, konvertimi i supozuar, dominimi absolut mashkullor. Është një lloj skenografie orientaliste: “gruaja e krishterë bëhet simbol i Evropës së robëruar nga Orienti, dhe Ali Pasha, simbol i një pushteti oriental njëkohësisht magjepsës dhe kërcënues”. Imazhi njëkohësisht qetëson dhe trondit, dhe në të njëjtën kohë i lejon Evropës ta reduktojë Ali Pashën nga një aktor politik kompleks, në një personazh legjendar, pothuajse përrallor. Realiteti historik është shumë më i paqartë dhe më shqetësues.

Për mua, në plan simbolik, Vasiliqia mishëron kufirin mes krishterimit dhe islamit, mes Evropës dhe Perandorisë Osmane, mes nënshtrimit të dukshëm dhe pushtetit të heshtur. Në pikurë, Vasiliqia nuk paraqitet si skllave haremi, por si një prani paqedashëse, që mban ekuilibrin midis frikës dhe butësisë.

Psikologjikisht, kjo marrëdhënie zbulon diçka thelbësore për Ali Pashën. Ai nuk zgjedh një grua nga bota e tij, por zgjedh « Tjetrën », një « Tjetër » të përmbajtur, politikisht jo kërcënuese. Ajo përfaqëson butësinë pa kërkesa, besnikërinë pa barazi, përkëdheljen pa reciprocitet të plotë. Një prani, që ai mund ta afroje pa rrezikuar sovranitetin e vet, gjë që përputhet me strategjinë jetike të Ali Pashë Tepelenës.

Imazhi i Ali Pashë Tepelenës me Vasiliqinë nuk është një skenë dashurie, por një alegori vizuale: ajo e një pushtetari që përpiket të pranojë një lloj influencimi, por pa e dorëzuar kurrë sovranitetin e tij. Në këtë imazh, Evropa projektonte ëndrrat dhe frikërat e saj mbi Orientin, duke e kthyer një marrëdhënie të heshtur në mit, dhe një njeri real në figurë legjendare.

Si përfundim, mund të themi se tablloja duke analizuar kuptimin e saj metaforik e enigmatik, nuk është simbolika e një çasti intim i dy të dashurve, por një rrëfim narrativ i pikturuar.

Bibliografi:

Carl Schmitt, Sovraniteti, përjashtimi, precedenti
Michel Foucault, Trupi, dënimi, ekspozimi si teknologji pushteti
Suraiya Faroqhi (2004): “Perandoria Osmane dhe bota përreth”, analiza historike mbi llogjikën e qeverisjes osmane.
Jane Burbank & Frederick Cooper (2010), Perandoritë.
Roland Barthes (1957), Mitologjitë.
Paul Ricoeur (2000) Historia, kujtesa, harresa.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Andi Hoti lirohet nga grumbullimi i Kombëtares

PRISHTINË, 29 MAJ - Qendërmbrojtësi Andi Hoti është liruar nga grumbullimi i Kombëtares së Kosovës pas lëndimit të pësuar gjatë seancës së djeshme stërvitore. Pas ekzaminimeve

të kryera nga stafi mjekësor i Kombëtares, është konstatuar se futbollisti i Eintracht Braunschweig ka pësuar pëlqim të njëjës talokrurale, lëndim i cili pritet ta mbajë jashtë fushës

për disa javë. Si rrjedhojë, Hoti nuk do të jetë në dispozicion të përzgjedhësit Franco Foda për dy ndeshjet miqësore të këtij grumbullimi. "Dardanët" kanë mbajtur të premtën

seancën e radhës stërvitore në stadiumin "Fadil Vokrri". Kombëtarja udhëton sot (e shtunë) drejt Pragës, kurse të dielën do ta zhvillojë ndeshjen miqësore kundër Çekisë.



'TRANSFERIMI I VITIT', XHAKA VLERËSOHET EDHE NGA 'BBC'-ja

SUNDERLAND, 29 MAJ - Pak ditë pasi "The Athletic" e ka vlerësuar transferimin më të mirë të Premierligës për edicionin 2025/26, Granit Xhakës i është dhënë çmim edhe nga "BBC"-ja.

Mediumi i madh anglez e ka vlerësuar kapitenin e Sunderlandit si transferimin më të mirë të sezonit në elitën angleze. "Rezultati pas votave të analistëve tonë është se Granit Xhaka e ka fituar çmimin e 'BBC'-së si transferimi më i mirë i sezonit në Premierë Ligë", ka shkruar "BBC"-ja.

Për Xhakën vlerësimet nga njohësit e futbollit ishin të gjitha pozitive. 33-vjeçari, që është edhe kapiten i Zvicrës, ka siguruar Ligën e Evropës me Sunderlandin. Ai është transferuar te Sunderlandi në



verën e vitit të kaluar dhe menjëherë është bërë kapiten i skuadrës.

Xhaka ka shënuar një gol dhe gjashtë asistime dhe shumë paraqitje të mëdha. Në vlerësimin e tij morën pjesë 96

analistë të futbollit në "BBC", ndërsa ishin 27 kategori të ndryshme për çmimet që janë dhënë në Premierligën, Premiershipin e Skocisë, Superligën të futbollistët dhe Ligën e futbollit anglez.

ETNIK BRRUTI ZYRTARIZOHET TE HAJDUKU I SPLITIT

SPLIT, 29 MAJ - Etnik Brruti është lojtar i ri i Hajdukut të Splitit. 22-vjeçari është transferuar nga Malisheva si lojtarë i lirë, duke nënshkruar kontratë katërvjeçare me gjigantin kroat. Te Hajduku ai do të luajë krahas bashkëkombësve të tij si Adrion Pajaziti dhe Ron Raçi. Brruti më parë ka përfaqësuar grupmoshat e reja të Kosovës, ndërsa për U21 të Kosovës ka luajtur tetë ndeshje. Ishte edhe kapiten i Kosovës U21, por më pas kishte vendosur ta përfaqësojë Shqipërinë. Me U21 të Shqipërisë, Brruti ka realizuar dy gola në tetë ndeshje. Ai ishte ftuar nga selektori brazilian Sylvinho te Shqipëria A. Vlera e Brrutit në "transfermarkt" është 550 mijë



euro. Brruti i ka kaluar katër vjet te Malisheva duke i zhvilluar 119 ndeshje dhe duke realizuar 15 gola dhe 12 asistime. Si pjesë e Malishevës ai e ka ndihmuar skuadrën të kualifikohet në garën evropiane të Ligës së Konferencës për tri vjet rresht.

SKANDAL NË BRAZIL PARA KUPËS SË BOTËS: MJEKËT GËNJYEN PËR DËMTIMIN E NEYMARIT

BRASILIA, 29 MAJ - Kur përzgjedhësi Carlo Ancelotti ka njoftuar se e kishte përfshirë Neymarin në skuadrën e Brazilit për Kupën e Botës, tifozët në vend ishin gëzuar, por tani një skandal i madh po zien. Siç shkruajnë mediet në Amerikën e Jugut, është gjithnjë e më e sigurt se Neymar ishte i lënduar kur kishte marrë telefonatën nga Ancelotti, dhe kjo është fshehur nga mjekët e klubit të tij Santos. Tashmë është konfirmuar se Neymar do të

mungojë për të paktën dy deri në tri javë për shkak të një dëmtimi në pulpë, që do të thotë se ai do t'i humbasë ndeshjet përgatitore kundër Panamasë dhe Egjiptit dhe, ndoshta, ndeshjen e parë të Kupës së Botës kundër Marokut. "Neymari mbërriti këtu në kamp dje dhe kaloi të gjitha testet mjekësore, të cilat përfunduan me një rezonancë magnetike. Ajo zbuloi një dëmtim të pulpës së këmbës të shkallës së dytë, jo vetëm edem. Pritet që ai të



jetë gati për rreth njëzet ditë në maksimum", ka thënë

mjeku i ekipit kombëtar brazilian, Rodrigo Lasmar. Disa medie braziliene dyshojnë se e fshehën dëmtimin e Neymarit te Santos në mënyrë që ftesa e Ancelottit për në Kupën e Botës të mos vihej në dyshim. Dyshohet se më 18 maj Shërbimi Kombëtar i Brazilit ka marrë një dokument të certifikuar nga mjekët e klubit se gjithçka është në rregull me ish-lojtarin e Barcelonës dhe PSG-së. Edhe presidenti i klubit, Marcelo Teixeira, ka

bërë deklarata në përputhje me letrën, duke thënë se nuk kishte asnjë arsye për t'u shqetësuar. Pas kësaj, nën presionin e publikut, Ancelotti e ka përfshirë Neymarin në listë, por ai menjëherë ua ka bërë me dije të gjithëve se nuk do të kishte një vend të garantuar në formacionin titullar. Tani është gjithnjë e më e sigurt se Neymar nuk do të jetë gati për Kupën e Botës, ku Brazili garon në një grup me Marokun, Haitin dhe Skocinë.

Messi do ta udhëheqë Argentinën në Kupën e Botës

BUENOS AIRES, 29 MAJ - Ashtu siç pritej, superylli i futbollit, Lionel Messi, do ta udhëheqë kampionen në fuqi, Argentinën, në Kupën e Botës që nis më 11 qershor.

38-vjeçari është përfshirë në listën prej 26 lojtarësh të përzgjedhësit Lionel Scaloni. Messi dhe rivali i tij i përhershëm, Cristiano

Ronaldo i Portugalisë, pritet të arrijnë rekord duke luajtur në Kupën e gjashtë të Botës. Kishte frikë se Messi mund të mos paraqitej në Botërorin që mbahet në ShBA, Meksikë dhe Kanada.


Futbollisti i Inter Miamit është ankuar për një lëndim në kofshën e pasme të këmbës së majtë në fitoren 6:4 ndaj

Philadelphias, duke shkaktuar panik te tifozët e Argentinës. Por Messi është pjesë e listës përfundimtare të Scalonit.

Tekniku argjentinas ka lënë jashtë listës talentin e Real Madridit, Franco Mastantuono, Gianluca Prestianin e Benficas, Marcos Senesin e Bournemouthit dhe Emiliano Buendian e Aston

Villas.

Prestianin i ka kushtuar mungesa në Botëror pas incidentit që e pati me Vinicius Juniorin e Real Madridit në Ligën e Kampioneve muaj më parë. Scaloni ka ftuar plot gjashtë lojtarë të Atletico Madridit. Argjentina do të përballet me Algjerinë, Austrinë dhe Jordaninë në



Grupin J. Para fillimit të turneut, Argjentina do të luajë ndeshje miqësore kundër Hondurasit dhe Islandës.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Real Fruits” SH.P.K. pronar Nerxhivane Bajrami me seli në Vushtri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812081131 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Real Fruits” D.O.O. Nerxhivane Bajrami Vushtri donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812081131 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Real Fruits” L.L.C. with owner Nerxhivane Bajrami with headquarters Vushtri, has come to the decision to quit its business: 812081131 the company has appointed a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Besian Gashi shpall të pavlefshme Diplomën e Masterit të Kolegjit UBT Prishtinë, me nr. 591/45-65.
- Nazmije Muhadri shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” Mazdrek.
- Valmir Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-9.
- Liridon Leniqi shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Hamëz Cena” Damjan Gjakovë nga kl. 1-8.
- “Restorant te Besi” SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 812064575.
- Vera Velija shpall të humbur numrin - unik identifikues 811608712 të lëshuar nga ARBK.
- Valbona Avdyli shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. “Sulejman Vokshi” në Smolicë Gjakovë nga kl. 1-8.
- Valentina Avdijaj nga Skivjani shpall të pavlefshme për herë të dytë diplomën e humbur dhe dëftesën e plotë të shkollës fillore “Ukshin Miftari”, Skivjan-Gjakovë.
- Çlirim Gjuraj nga Gërçina e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F.M.U “7 Shtatori”, nga klasa e 6-9.
- Fitim Sylja shpall të pavlefshme 4 dëftesat si dhe diplomën e sh.m.h.t. “7 Shtatori” Prishtinë.
- Vilson Gjykej nga Novosella e Gjakovës shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës SH.F.M.U “Engjëll Gjoni”, Novosellë, nga klasa 1-8.
- Arta Salihi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.
- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.
- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.
- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

